

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NOTERE

Elsa E. Ferizaj
Rruga "Bardhok Biba"
TIRANE

NR.195..... REP
NR.33/..... KOL
3



KONTRATË SHIT - BLERJE AKSIONESH

Ne Tirane sot ne date 22.02.2016 (*dymije e gjashtëmbdhjete*), para meje noteres Elsa Ferizaj, notere e Dhomes se Noterise Tirane, qe ushtroj veprimtarine ne zyren e ndodhur ne Rrugen "Bardhok Biba", u paraqiten personalisht Shitësi dhe Blerësi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate Shti-Blerje Aksionesh, me termat e mëposhtme:

SHITËSI:

Znj. Ermelinda Ndrenika, atesia Elmas, lindur në Fier, më datë 13.09.1978, dhe banuese në Tiranë, Rruga "Sh.Berxolli", pajisur me me letërnjoftimin (ID) me Nr. Personal H85913146P, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar,

BLERËSI:

Z. Luan Caca, atesia Myfit, lindur në Tepelene, më datë 04.11.1974, dhe banuese në Tiranë, Rruga Kavajes Tirane, pajisur me me letërnjoftimin (ID) me Nr. Personal H41104045M, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar,

OBJEKTI: Shitja e aksioneve të shoqërisë "**Red Technology Solution (RTS)**" Sh.P.K. në masën 25% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë, të zotëruara nga aksioneri i shoqërisë zj. **Ermelinda Ndrenika**, me cilësinë e shitësit, dhe blerja e tyre nga **Z.Luan Caca**, me cilësinë e blerësit.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "**Red Technology Solution (RTS)**" Sh.P.K. shoqëri e themeluar dhe e regjistruar pranë Qendrës Kombetare të Regjistrimit (QKR) më datë 12.03.2014, me numër biznesi (NIPT) L41512005R.

Shoqëria ka një kapital të regjistruar prej 100.000 leke, të zotëruar nga Aksionerët e shoqërisë në këtë mënyrë:

1. Z.Luan Caca , zotëron 25 %, të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë më vlerë të përgjithshme 25.000 lek.
2. Z.Gerti Zotkaj, zotëron 25 %, të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë më vlerë të përgjithshme 25.000 lek

3. Zj.Erjola Celami, zotëron 25 %, të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me vlerë të përgjithshme 25.000 lek
4. Zj.Ermelinda Ndrenika, zotëron 25 %, të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me vlerë të përgjithshme 25.000 lek

Me vendimin e datës 15.12.2015, të Asamblese se Ortakeve te Shoqërisë është dhënë miratimi për shitjen e aksioneve në masën prej 25% që zotëron zj.Ermelinda Ndrenika në favor të blerësit z.Luan Caca, që do të blejë masën prej 25% të aksioneve.

Shitja e masës prej 25% të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë **“Red Technology Solution (RTS)” Sh.P.K**, sjell humbjen e së drejtës së pronësisë së aksionerit zj.Ermelinda Ndrenika për pjesën e shitur, përkatësisht të masës prej 25% të aksioneve, kjo si pasojë e këtij transaksioni shit-blejje aksionesh, shprehur dhe në vendimin e datës 15.12.2015, të Asamblese se ortakeve te Shoqërisë.

Shitësi, zj.Ermelinda Ndrenika, me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë është plotësisht dakort për shitjen e aksioneve në masën 25%, aksione të cilat do të shiten në favor të blerësit z.Luan Caca.

Nga ana tjetër, z.Luan Caca, është plotësisht dakort të blejë përkatësisht masën prej 25% të aksioneve, të cilat shitësi i zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë **“Red Technology Solution (RTS)” Sh.P.K**, duke fituar në këtë mënyrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga transferimi i pronësisë së aksioneve, dhe në të njëjtën kohë behet aksioner me 50 % të aksioneve në shoqërinë e mësipërme.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësi zj.Ermelinda Ndrenika humbet pronësinë përkatësisht në masën prej 25 % të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë **“Red Technology Solution (RTS)” Sh.P.K**, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këto aksione. Ndërsa Blerësi z.Luan Caca bëhet pronar në total në masën 50 % të aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Pas realizimit të kësaj kontrate shit – blejje, aksionet e shoqërisë **“Red Technology Solution (RTS)” Sh.P.K**, do të zotërohen në këtë mënyrë:

1. Z.Luan Caca , zotëron 50 %, të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me vlerë të përgjithshme 50.000 lek.
2. Z.Gerti Zotkaj, zotëron 25 %, të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me vlerë të përgjithshme 25.000 lek
3. Zj.Erjola Celami, zotëron 25 %, të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me vlerë të përgjithshme 25.000 lek.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blejje të aksioneve të shoqërisë tregtare **“Red Technology Solution (RTS)” Sh.P.K**, do të jetë vlera prej 25.000 lek e cila i referohet vlerës nominale të një aksioni të parashikuar nga ligji.



Sipas këtij përcaktimi Blerësi **z.Luan Caca**, paguan në favor të Shitësit **zj.Ermelinda Ndrenika** shumën 25.000 (njetete pese mijë) lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të kenë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në 5 (pese) kopje të njëjta, nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Regjistrin Tregtar, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.

Termat e kontratës, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, në prezencën time.

PALËT

SHITËSI

Ermelinda Ndrenika

Ermelinda Ndrenika
[Signature]

BLERËSI

Luan Caca

Luan Caca
[Signature]

NOTER

ELSA FERIZAJ

[Signature]
[Notary Seal: NOTER TIRANE]